

George Bush i vjetër e shihte gjendjen në Kosovë në vitin 1992, si “një tenxhere me presion, para shpërthimit”, derisa në Bosnjë lufta veç kishte nisur. Në një takim që kishte me kryeministrin e atëhershëm grek, Konstantin Mitsotakis, në Dhomën Ovale ata po bisedonin se si mund të parandalohet eskalimi i situatës.

Kryeministri grek ishte ai që i thoshte të parit të SHBA-së, se në Kosovë, duhet bërë një përpjekje shumë e rëndësishme, për të parandaluar shpërthimin e situatës. Ai propozonte mos ndryshimin e kufijve, një autonomi duke anashkaluar të drejtën për vetëvendosje. “Ju keni plotësisht të drejtë. Ju mund të jeni me ndikues për të ndihmuar që kjo të ndodhë”, i thotë me këtë rast Presidenti Bush.

Greçia paralajmëronte Presidentin e SHBA-ve edhe për problemin e emrit të Maqedonisë. Bush i premtojte atij se do të merrej me këtë çështje, e kryeministri grek e lut edhe që SHBA të ndihmojë Greqinë për të parandaluar pranimin e këtij vendi (Maqedonisë v.j.) në OKB, sepse, siç thotë ai, në qoftë se ata do të pranohen, ky diskutim është i pavlerë.

Temë e nxehtë aty është edhe Bosnja, dhe mënyra se si ata dhe serbët e urrenin njëri tjetrin. Transkriptin e plotë e sjell gazeta Tema.

President Bush: Dua të ju uroj mirëseardhjen mikun tim të vjetër Konstantin Mitsotakis në Shtëpinë e Bardhë dhe dua të shprehi admirimin dhe respektin tim. Unë kam kënaqësinë të punojmë së bashku. Më vjen keq që ne nuk ishim në gjendje të përparojmë më tej në Qipro. Unë e di se sa shumë vështir ishte. Por të jeni të sigurt, askush nga ne nuk do të heqë dorë.

Kryeministri Mitsotakis: Së pari, unë dua të ju falënderoj ju zoti President, për të gjithë çka që ju keni bëri për Greqinë dhe marrëdhëniet greko-amerikane. Edhe vërtetë e vlerësoj kontaktet tona personale dhe të miqësisë. Ju arritët që të sillni marrëdhëniet midis dy vendeve tona në një nivel që ne kishim dëshiruar- kjo është shumë e rëndësishme.

Presidenti Bush: Dua të dëgjoj pikëpamje tuaja në lidhje me gjendjen në Jugosllavi.

Kryeministri Mitsotakis: Siç i tregova edhe Sekretarin Eagleburger, situata është kritike. Vendi im, dhe unë personalisht, jam i të gatshëm për të ndihmuar për të gjetur një zgjidhje për këtë situatë të vështirë. Ne duam për të vendosur marrëdhëniet tona tradicionalisht të mira me Serbinë në shërbim të të mirave të përbashkëta. Ne jemi të gatshëm për të marrë ndonjë veprim që ju do të donit – për të ndikuar të serbët për ti hapur rrugë zgjidhjeve paqësore, etj

Presidenti Bush: Ne ju inkurajojmë juve që të përdorni ndikimin tuaj. Ne jemi përpjekur. Ne jemi shumë të shqetësuar në lidhje me situatën. Kjo është me të vërtetë e tmerrshme, sidomos për fëmijët. Shumë njerëz janë duke me inkurajuar mua për të përdorur të gjitha llojet e forcës ushtarake. Por vendimi im nuk do të pritët mirë nga qytetarët amerikan në qoftë se unë do të të dërgoj ushtar amerikan në një situatë që është e paqartë dhe ku ne nuk mund të fitojmë. Gjendja humanitare është shqetësimi ynë më i madh. Këto janë rivalitetet historike. Greqi a nuk mund ta zgjidh këtë problem; dhe as Shtetet e Bashkuara nuk mund ti zgjidhin ato.

Kryeministri Mitsotakis: Lufta në Bosnjë nuk do të përfundojë aq shpejt.

Presidenti Bush: Të gjithë e urrejnë njëri-tjetrin aq shumë. Kjo është mjaft e keqe për politikën amerikane.

Kryeministri Mitsotakis: Në Kosovë, duhet bërë një përpjekje shumë e rëndësishme për të parandaluar shpërthimin e situatës.

Presidenti Bush: Është si një tenxhere me presion, para shpërthimit.

Kryeministri Mitsotakis: Gjëja më e rëndësishme në gjithë këtë është që të kemi kufij të pandryshueshëm. Kufijtë e jashtëm dhe të brendshëm. Zgjidhja në Kosovë mund të jetë një shtet duke favorizuar një autonomi duke anashkaluar të drejtën për vetëvendosje. Ne mendojmë se shqiptarët kanë filluar të kuptojnë këtë. Serbët dhe shqiptarët duhet gjetur një mënyrë për të arritur një mirëkuptim.

Presidenti Bush: Ju keni plotësisht të drejtë. Ju mund të jeni me ndikues për të ndihmuar që kjo të ndodhë.

Kryeministri Mitsotakis: Një çështje tjetër shumë e ndjeshme për popullin grek është edhe Maqedonia. Ne do të diskutojmë për këtë në Edinburg.

Presidenti Bush: A jeni optimist? Ne kemi shumë shpresë.

Kryeministri Mitsotakis: Unë nuk mund të bëjë asnjë parashikim. Ajo që unë u përpoqa të shpjegojë këtë edhe Sekretarit Eagleburger dhe Gjeneralit Scowcroft është se qasja jonë është pozitive. Ne duam që kjo republikë të ekzistoj dhe ne kemi ndërmarrë disa nisma në këtë kuptim. Për ne, ka garancitë kufitare. Shqipëria, Bullgaria, Serbia dhe të gjitha e bënë këtë deklaratë. Ajo që ne nuk mund të pranojmë është emri i tyre zyrtar për të përfshirë termin Maqedoni.

Unë do të jem shumë i sigurtë. Nëse diçka e tillë do të ndodhë, do të ketë destabilizim të vërtetë. Por, kjo çështje mund të zgjidhet tani si një pikënisje për një qasje pozitive. Deri tani me Jugosllavinë ne kemi pasur shumë dështime, pse mos të provojmë një here që të arrijmë një sukses? Përfshirja e Maqedonisë në emër të tyre zyrtar është i dëshiruar nga më pak se 50% e popullit. Një sondazh i kohëve të fundit ka rezultuar në jo më shumë se 17% të popullsisë që duan këtë emër.

Presidenti Bush: Atëherë pse administrata maqedonase është duke u mbetur peng i emrit?

Kryeministri Mitsotakis: Ka diçka që fshihet pas saj, prej periudhës së komunizmit. Nuk është e lehtë për administratën aktuale që të çlirohet nga kjo trashëgimi nga periudha komuniste. Demokracia në këto hapësira do të jetë një makijazh kozmetikë. Komunistët e vjetër nga linja Titos ende mbajnë pushtetin. Por Gligorov është një njeri serioz. Një marrëveshje mund të arrihet me të. Kjo është arsyeja pse zgjidhja që ne kemi sugjeruar është një formulë e mirë.

Presidenti Bush: Unë do të bëjë një deklaratë, dhe unë do të doja që ju të më tregoni çfarë është e gabuar me të. Por së pari, unë dua të them se unë vlerësoj marrëdhëniet tona. Çdo amerikan e di se marrëdhëniet tona janë shumë, shumë të mira.

Por, deklarata ime është kjo: Kjo Republikë ka kaluar arritshmërinë e demokracisë së saj dhe statusit në përputhje me parimet e Helsinkit. Ajo ka vazhduar dhe zhvilluar veten në një mënyrë pothuajse shembullore. Kështu që mua me duhet ti them dy gjëra: Ata kanë zbatuar Marrëveshjet e Helsinkit dhe performanca e tyre ka qenë shembullor. A jeni dakord me ato pika, ose ju grekët i shikoni gjërat me ndryshe?

Kryeministri Mitsotakis: Unë nuk do të pajtohesha se ata janë një demokraci shembullore. Por kjo është një republikë që ne mund ta tolerojmë.

Presidenti Bush: Jo, unë nuk jam duke thënë për një demokraci shembullore, por se e kanë ndjekur atë në një mënyrë shembullore.

Kryeministri Mitsotakis: Unë pajtohem. Po. Kjo është pikërisht arsyeja pse ne kemi probleme me këtë republikë dhe ne duam që ajo të ekzistojë. Por ne nuk mund të pranojmë emrin. Pas Lisbonës – të cilat na arsyetohet – reagimi i Gligorov ka qenë për të provokuar Greqinë. Kjo republikë u krijua nga Tito dhe Stalini pas Luftës së Dytë Botërore në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara; gjenerata ime e di këtë. Por njerëzit në pushtet në Shkup janë të njëjta – kur ata e përdorin këtë emër, ne bëhemi shumë të dyshimtë. Ne duam që ata të ndalojnë përdorimin e këtij termi dhe duke lënë të kuptohet se ata kanë kërkesa ndaj nesh. Edhe në kushtetutën e tyre ata kanë dispozitë për shtetasit jashtë vendit, duke përfshirë edhe në Greqi. Kjo është arsyeja pse ne kemi bërë kërkesë të vetme që ata zgjedhin një emër tjetër. Ne nuk mund të pranojmë këtë – asnjë qeveri greke nuk mundet ta pranojë. Përndryshe ne do të përballemi me destabilizim.

Presidenti Bush: Doja të jem i sigurt, nuk ka asnjë problem tjetër përpos emrit?

Kryeministri Mitsotakis: Një tjetër problem ne kërkojmë nga SHBA për të na ndihmuar që të parandalojmë pranimin e këtij vendi në OKB, sepse në qoftë se ata do të pranohen, ky diskutim është i pavlerë.

Presidenti Bush: Por në qoftë se ju nuk keni probleme me emrin, ajo mund të shkojë përpara.

Kryeministri Mitsotakis: Unë kërkoj nga ju në qoftë se ju mund të ndihmoni që kjo të shtyhet.

Presidenti Bush: Ne do të shohim së çfarë mund të bëjmë.

Kryeministri Mitsotakis: Është shumë e rëndësishme. Do të ishte një tragjedi. Unë nuk mund ta përballojë atë. Nëse nuk e teproj, unë do të përpiqem të bëjë kompromis. Por nëse kjo ndodh kjo do të ishte një tragjedi për Greqinë dhe për mua.

Presidenti Bush: A ka ndonjë ndarje të opinionit për këtë në vend në Greqi?

Kryeministri Mitsotakis: Jo. Kjo është e vetmja çështje ku Papandreu dhe ish-Ministri i Jashtëm Samaras dhe unë jemi dakord.

Presidenti Bush: Ne do të përpiqemi dhe të shpresojmë, ndoshta ne mund të ndihmojmë që kjo të shtyhet.

Kryeministri Mitsotakis: Është shumë e rëndësishme për ne që kjo të shtyhet gjatë periudhës së përkohshme. Unë me të vërtetë llogarisë në ju zoti President.

Presidenti Bush: Më thuaj, sa gjatë do të jetë ekspozita e objekteve të antikitetit?

Kryeministri Mitsotakis: Deri në mars.

Presidenti Bush: Shpresoj që do të vij për të parë atë.

Kryeministri Mitsotakis: Më lejoni t'ju them përsëri, ju lutem ejani në Greqi!

Shtëpia e Bardhë WASHINGTON.

Takimi me kryeministrin e Greqisë Mitsotakis

Presidenti

Nën Presidenti

Lawrence S. Eagleburger, ud. Sekretar i Shtetit

Brent Scoëcroft, Asistent i Presidentit për Çështje të Sigurisë Kombëtare

Konstantine Mitsotakis, Kryeministri Greqisë Andreas Andrianopoulos, Ministri i Shtetit Dora Bakoyanni, Zëvendësministre në Qeveri

Transkripti i bisedës KONFIDENCIALE

DATA, KOHA 17 nëntor 1992, 2:00-14:45 DHE VENDI: Zyra Ovale